



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 3 Datë 24.01.2018

“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “ERALDI & PSM” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, miratimin paraprak Nr. 7513/7, datë 24.10.2016 dhe shtyrjen e afatit të përcaktuar në miratimin paraprak me shkresën nr.1732/1 Prot. datë 05.12.2017 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujor të subjektit “ERALDI & PSM” SH.P.K, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin e lejes së subjektit“ERALDI & PSM” sh.p.k. me administrator Z.Genc Marku, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Bugjonit**, për prodhim energjie elektrike në Bashkinë Fushë – Arrëz, Qarku Shkodër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC BUGJON do të ketë këto të dhëna:

Vepra e marrjes Nr.1:	$X_1 - 44\ 17\ 280;$	$Y_1 - 46\ 78\ 886;$	$Z_1 - +385\ m;$
Vepra e marrjes Nr.2:	$X_2 - 44\ 16\ 755;$	$Y_2 - 46\ 79\ 079;$	$Z_2 - +384\ m;$
Koordinatat e godinës së centrali:	$X - 44\ 16\ 801;$	$Y - 46\ 81\ 241;$	$Z - +185\ m;$
Koordinatat e pikës së shkarkimit:	$X - 44\ 16\ 801;$	$Y - 46\ 81\ 241;$	$Z - +185\ m;$
Prurja mesatare vjetore e burimit:	$Q\ mes = 0.72\ m^3/sec;$		
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti:	$Q\ llog = 0,7\ m^3/sec;$		
Prurja ekologjike:	$Q_{ekol} = 0.06\ m^3/sec;$		
Prurja që shkarkohet:	$Q = 0.7\ m^3/sec.$		

2-Leja e përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLIJA

